



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 61

Datë: 06. 11. 2017, ora: 15:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Eshref Vishi, Stevan Veselinoviq, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP; Përkthyesë: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.60/2017;
2. Certifikimi i Rezultateve për Kryetar Komune për pesë komuna, për zgjedhjet e 22 tetorit 2017;
3. Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.60/2017

Valdete Daka: Mirë se keni ardhë. Kemi kuorum. A ka dikush ndonjë vërejtje, sugjerim lidhur me rendin e ditës...? Nëse jo, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Valdete Daka: Atëherë, sa i përket procesverbalit....! Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së nr.60/2017

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër, e ajo është për certifikimin e rezultateve për Kryetar Komune për pesë (5) komunat e mbetura, duke mos e përfshirë edhe Parteshin, sepse në Gjykatën Supreme, është deponuar një ankesë kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Betim Gjoshi: Unë, normalisht që do të votoj për këto pesë komunave por, duke pasur parasysh kompozimin e KQZ-së, jo që ka ndodhur ndonjëherë, por nuk është mirë t'i ndajmë komunat kështu...! Ky, është mendim im se, nuk kishte filluar procesi zgjedhor me një komunë ose votimi jashtë vendit në një komunë, që të jenë më herët apo më vonë. Duhet të ketë parasysh që, unë herën e kaluar qëllimisht nuk kam marrë pjesë për këtë arsye se nuk ndahen komunat. Ne, i kemi shpallur zgjedhjet për një ditë, pastaj është raundi i dytë...! Ne, pa marr parasysh a ka apo nuk ka ankesa me i nda nuk ka kuptim...Ta marrim parasysh që të njëjtën ditë, ne e kemi pas marr vendimin e PZAP-it për këto komuna, dhe kemi mundur po atë ditë t'i certifikojmë krejt, ka qenë çështje orësh me i mbyll....!

Kjo, tha z. Gjoshi, është sa i përket mendimit tim. Sa i përket çështjes tjetër, asaj të Parteshit, sot nuk mundemi me certifikuar...Për mua, është një vendimi pa afatshëm, është një gabim i organeve qysh janë duke na shkaktuar, dhe duke na e dëmtuar imazhin e zgjedhjeve. Unë, sot edhe një herë e kam konsumuar Ligjin e Zgjedhjeve dhe, me të vërtet janë duke na sfiduar për shembull, organi i papërgjegjshme siç është PZAP-i dhe Gjykata Supreme! Është mirë që janë vëzhguesit ndërkombëtar, dhe marrin shënime këtu...

Ligji, tha z. Gjoshi, i njuh vetëm dy afate të ankesave: një afat 24 orë pas përfundimit të zgjedhjeve që i ka ra ditën e hënë, është shprehimisht sipas nenit 13-të për ndryshim, plotësim të ligjit të zgjedhjeve që ndryshon neni 119...Është afati 24 orë për atë që ndodh në QNR, prej momentit të ndodhjes, dhe nuk ka afat tjetër në ligj. Ne, mundemi me pas sot për një komunë, po e marrim shembull në Pejë edhe me pa filmime që janë mbushur kutiat por, më ka përfunduar ajo punë! Ne, mundem t'i dërgojnë në burg ata njerëz, në qoftë se ka pasur vjedhje të votave në Partesh. Sa i përket rezultatit 24 orë, ka përfunduar procedura, dhe neve janë duke na sfiduar rënd. Nuk e di a është taksirat për ta mbyllur atë institucion, ose e dyta, po mundohen të kallëzohen të mençur dhe të rëndësishëm! Me të vërtetë, kjo është sfidë: me pas ndodh në një komunë tjetër, unë personalisht ua kisha dërguar krejt votuesit te dera...Se, edhe i kam parë të gjitha vendimet që ju kanë dërguar kandidatëve për asamble, krejt janë dallash (gabim). Nuk ka ankesa të tjera për atë që ka ndodh rinumërimi në vendvotim, veç asaj 24 orëshit që tashmë ka qenë.

Lidhur me QNR-në, tha z. Gjoshi, për mos tabulim të rezultateve në rregull, për numërim të votave me kusht, dhe për të tjera probleme, afati ka përfunduar. Bile, tash me ndryshim të ligjit të ri të këtyre, kjo është shumë e qartë....! Aty shkruan shprehimisht: çdo rregull zgjedhore, edhe ligj që është shkelur brenda 24 orëve pas mbylljes, nuk ka asnjë alternativ tjetër. Por, në këtë vend, duhet dikush t'ia tërheq vërejtjen këtij institucioni. Me të vërtetë edhe neve po na e prishin imazhin, se ne i kemi mbajtur një palë zgjedhje të mrekullueshme, dhe tash del në lajme që, e kanë dërguar një komunë në zgjedhje. Mos të bëhet hajgare, ne nuk kemi qare pa i mbajtur nëse Gjykata Supreme e vërteton atë farë vendimi, ne kemi m'i mbajtur zgjedhjet por, po ju tregoj drejt se kjo është tmerr çka jemi duke i bërë këtij vendi. Sa here ju teket atyre...! Unë, nuk e di çka kanë me b'a në rinumërim të kandidatëve! Ne, mundemi t'i kemi rezultatet ndoshta të premtën, të shtunën apo të enjten, nuk e di, nuk është me rëndësi tash por, atyre me ju tekë ja nisin edhe njëherë prej fillimit. Duhet ta dimë kur përfundon se, i rrezikojnë proceset. Çka, nëse nesër vendos Gjykata supreme ndryshe, çka me vendos me kthye në apelim në PZAP...?

Valdete Daka: A ka edhe dikush diçka se, unë e kuptoj shqetësimin e Betimit, në fakt është kogja e saktë në ata çka ka ndodhë në ditën e zgjedhjeve, dhe afati është 24 orë pas mbylljes së vendvotimit, dhe jo pasi që të shpallen zgjedhjet përfundimtare. Në një formë, tash jemi gjend me një situatë të vështirë, kemi obligim me e zbutuar dhe me e implementuar këtë vendim. Nuk kemi ndonjë mundësi tjetër, gjithsesi mbetet të diskutohen këto çështje. ...

Betim Gjoshi: Paramendoni, e kanë marrë vendimin të etjen, e ne qe ku jemi këtu, e të premtën e kemi pa në gazetë...Është dashtë na me pa vendimin, po ata se kanë sjellë as të premtën...Po jo more, ai instituciona sanitar është dashtë me e mbyllë, ky është një institucion katastrofal...

Sami Hamiti: Kryetare, nuk po mundem pa diskutuar...! Është e vërtetë që po na sfidojnë. Në radhë të parë, është e vërtetë se një vendim duhet me b'a që me tregu se nuk është në rregull, m'i thanë të gjitha, për mos me thanë që deri diku ka drejtë, do të thotë, se është problem...Tash, është duke u bërë nërinumërim në Qendër të Numërimit atje poshtë. Janë kutitë, dhe unë jam shkue, e kam vizituar 3-4 here dhe kam shikuar se çka është kah bahet...! Atje, është kah bahet një punë shumë e madhe. Merreni me mend: PZAP nuk është atje, thjeshtë, tash nesër apo pasnesër kanë me i q'ue kutitë e njëjta në rinumërim. Edhe s'don me e b'a se nuk dinë qysh me ba rinumërimin...! Këta shkojnë e i përcjellin zgjedhjet në Bullgari e në Maqedoni, Kroaci e nuk shkojnë në QNR...? A thua pse...? Le të vijnë e le të trajnohet këtu se, trajnerët janë, i marrin e i mësojnë se qysh duhet me u mbyllë kutiat...! Mbasi që kryhet puna në QNR, do ta shihni: kanë me i dërgua kutiat e njëjta në rinumërim se nuk vijnë fare me e përcjellë procesin...

Betim Gjoshi: Kanë qenë 270 ankesa, i kanë kthye njerëzit mbrapa, e ata kanë shkuar me u ankuar...! I kanë kthye, a o kanë afati me u ankuar...Na, duhet vazhdimisht me u ruajte prej disa personave në Gjykatë Supreme, e prej do tjerëve në PZAP...

2. Certifikimi i Rezultateve për Kryetar Komune për pesë (5) komuna, për zgjedhjet e 22 tetorit 2017

Valdete Daka: Atëherë, nëse nuk ka diskutime tjera, po i kthehemi pikës së fillimit, e ajo është certifikimi i rezultateve për kryetar komune, për këto 5 komuna: komuna e Kamenicës, e Junikut, e Istogut, e Obiliqit dhe e Drenasit. Kush është për certifikimin e këtyre rezultateve...?

Anëtarët e KQZ-së në mënyrë unanime miratuan certifikimin e rezultatit në këto komuna.

Valdete Daka: Ju faleminderit...Për komunën e Parteshit, besoj se e marrim nesër vendimin nga Gjykata Supreme, dhe vendosim për certifikim...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
